




VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA NË EMËR TË POPULLIT
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC



10.04.2018
 GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPATAMENTI I PËRGJITHSHËM -
 Devizioni penal , në përbërje nga gjyqtari vetëm gjykues, Hysnije Gashi, dhe zyrtare
 ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga [REDACTED]
 [REDACTED], Komuna [REDACTED], për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 358
 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2012-
 2/17, e dates, 18.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të
 shtetit, Albert Zejnullahu dhe të pandehurit, më dt. 28.02.2018 të njejtë ditë mori dhe
 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

[REDACTED] me vendbanim në [REDACTED], Komuna [REDACTED] i lindur me
 [REDACTED], në të njetin vend, nga i ati [REDACTED], e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], i pa
 punë, gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE

Me datën 10.09.2017, rreth orës 15:00, në pyllin publik, në vendin e quajtur “Paralelja
 “,-61, në në Rajonin Ekonomiko Pyjor –Neodime-Jezercë, i pandehuri eshte takuar duke
 prerë 2 copë e trangu te ahut te njom , me diametër 40-50 cm, me vëllim të përgjithshëm
 prej 2,95 metra kub, e ne vlerë prej 398,25€, drunjtë kanë qen të prerë me sharrë motorike
 e të bartur me traktor te markës IMT-39, me rimorkio,-

Me të cilën kryen veprën penale vjedhje pylli nga neni 358.par.1 të KPRK-së

GJYKON

DËNIM ME BURG

I zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme

Të akuzuarin:

1. [REDAKTUAR]

Cakton dënim burgu në kohëzgjatje prej 1(një) muaj.

Bazuar në nenin 48 par. 1.3 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurit dënimi me burgim I zëvendësohet: me **PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME** prej 120 (njeqinde njezet) orësh të cilen do ta kryej pa pagesë në afat prej 1(një) muaji, prej ditës së fillimit të ekzekutimit

Konformë nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues I Kosovës, cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton Organizaten në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditët, javët që të dënuarit duhet të kryejn punët në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikqyer punen në dobi të përgjithshme.

Në mbështetje të nenit 48 par. 4 të KPK-së nëse i pandehuri nuk e kryen punen në dobi të përgjithshme, ose e kryejn pjesërisht, gjykata do të urdhëroj zbatimin e dënimit me burgimin e shqipëtuar, përkatësisht në pjesëtim me punen e kryer.

Obligohet i akuzuari që DBPZHR-në –zyra në Ferizaj, të ia paguajn shumën në vlerë 398,25 €.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë conform nen. 450 të KPPK-së i pandehuri obligohet që ne emer të paushallit gjyqësore në shumën prej 20.-€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarrimit me dhunë.

Ar sy e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.2012-2/17, e dates, 18.10.2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR], për veprën penale vjedhje pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK -së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 01.02.2018, Prokurori i shtetit Albert Zejnullahu, në shqyrtimin gjyqësorë, mbeti në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, duke i propozuar gjykatës që i të akuzuarin ta shpallet fajtor dhe të dënohet sipas Ligjit.

I pandehuri [REDAKTUAR], në shqyrtimin fillestar, ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale duke shprehur pendimin për veprën të cilën i kanë kryer.

Gjykata vlerësoi se janë plotësuar kriteret nga nen. 248 par. 1 të KPP pasi që të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se një pranim i tillë është bërë vullnetarishtë dhe mbështetet në provat, dhe materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit siq janë : fletëparaqitja e rojës së pyllit me vlersim dhe llogaritjen e demit të pyllit me nr. 634/2017I dates 18.09.2017, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabim faktik, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPP ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, po ashtu Gjykata konform nenit 366 po atë ditë ka shpallur aktgjykimin.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje e pyllit nga nen. 358 par.1 të KPRK .

Me rastin matjes e llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nen. 73 të KPRK-së.

Si rrethana lehtësuese gjykata mori parasysh faktin se i pandehuri e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale, pendimin që ka treguar si dhe faktin se i pandehuri është I të gjendjes së varfer ekonomike, dhe është i pa punë, ndërsa si rrethan rënduese Gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësis penale si dhe rrezikshmërinë e veprës penale, në kuptim

të të gjitha këtyre rrethanave i shqipëtoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se një dënim i tillë është proporcional me shkallen e përgjegjësis penale të pandehurit, intenzitetit e rrezikshmërisë shoqërore të vepres penale si dhe me te do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Obligohet i akuzuari që DBPZHR-në –zyra në Ferizaj , të ia paguajn shumën në vlerë 398, 25 €.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë conform nen. 450 dhe të KPPK-i pandehur obligohet që ne emër të paushallit gjyqësore të paguj shumën prej 25.-€,në afat prej 15 ditësh,nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarrimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1267/17 të dates 28.02.2018

Zyrtare ligjore:

Albana Ujupi



Gjyqtari i vetem gjykues:

Hysnije Gashi

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.